| **Nr rendor.** | **Data e Kërkesës.** | **Objekti i kërkesës.** | **Data e përgjigjes.** | **Përgjigje.** | **Mënyra e përfundimit të kërkesës.** | **Tarifa.** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 09.01.2023 | Gazetare, O, A info per satelitet | 16.01.2023 | Kthyer përgjigje sipas pyetjeve | E plote | Nuk ka. |
| 2 | 10.01.2023 | A. E, LL Bashkia Kamëz përmbytjet 2017 | 16.01.2023 | Prefekti i Qarkut Tiranë nuk ka përcjellë dokumentacion tekniko-ligjor për shtetasin A. Ll., për rastin e përmbytjeve të vitit 2019.<br>AKMC nuk ka detyrim financiar për shtetasin A. Ll. | E plote | Nuk ka. |
| 3 | 10.01.2023 | D.A Bashkia Tirane,përmbytjet 2013 | 23.01.2023 | AKMC i ka kërkuar Bashkisë Tiranë, vënien në dispozicion të dokumentacioneve tekniko-ligjore | E plote | Nuk ka. |
| 4 | 11.01.2023 | D.U, Bashkia Tirane përmbytje 2013 | 17.01.2023 | AKMC nuk disponon dokumentacion tekniko – ligjor të hartuar nga Bashkia Tiranë, për rastin e përmbytjeve të vitit 2013 në banesën tuaj | E plote | Nuk ka. |
| 5. | 11.01.2023 | H. H. T, Kamëz, përmbytje 2017 | 16.01.2023 | AKMC nuk ka më detyrim financiar ndaj jush. | E plote | Nuk ka. |
| 6. | 12.01.2023 | L. LL, per M.L Kamëz, Përmbytje 2017 | 16.01.2023 | AKMC pas verifikimit të dokumentacionit tekniko-ligjor dhe përputhshmërisë me legjislacionin në fuqi, si dhe brenda mundësive të saj financiare, do të realizojë kompensimin | E plote | Nuk ka. |
| 7. | 13.01.2023 | SH. B. Kamëz, përmbytje 2017 | 16.01.2023 | AKMC nuk ka detyrim financiar ndaj jush | E plote | Nuk ka. |
| 8. | 17.01.2023 | Kërkesë per informacion nga ACQJ, D. H | 26.01.2023 | Kthyer përgjigje sipas pyetje | E plote | Nuk ka. |
| [475062] | 19.01.2023 | Delegim ankese - Banoret e Rruges Arapi (Ministritë e Linjës) | 25.01.2023 | Ankesa i është përcjellë për kompetencë Bashkisë Tiranë | E plote | Nuk ka. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| [482258] | 19.01.2023 | Delegim ankese - P H (Ministritë e Linjës) | 24.01.2023 | Pritet trajtimi i plotë i rastit pas përcjelljes së informacionit të kërkuar nga ana e Bashkisë Pogradec. | E plote | Nuk ka. |
| [475868] | 19.01.2023 | Delegim ankese - T B (Ministritë e Linjës) | 20.01.2023 | Bazuar në kuadrin e mësipërm ligjor, për dëmet e shkaktuara si pasojë e rrëshqitjes së dherave, administrimi me qëllim trajtimin financiar është kompetencë e Bashkisë Mirditë. | E plote. | Nuk ka. |
| [479562] | 19.01.2023 | Delegim ankese - T S (Ministritë e Linjës) | 21.01.2023 | Detyrimi ynë financiar ndaj rastit në fjalë është përmbushur | E plote | Nuk ka. |
| [430029] | 19.01.2023 | Komunikim i brendshëm - xh K (Ministritë e Linjës) | 20.01.2023 | Rasti në fjalë, nuk është objekt trajtimi nga AKMC | E plote. | Nuk ka. |
| 9 | 27.01.2023 | Ankesë B D V dhe B B V - për kompensim financiar si rezultat i zjarrit të rënë në banesën e tyre në fshatin Helshan, Bashkia Mat | 27.01.2023 | Administrimi i rastit të mësipërm është kompetencë e Bashkisë Has | E plote. | Nuk ka |
| 10 | 30.01.2023 | V. K, Bashkia Kamez, përmbytje 2017 | 01.02.2023 | AKMc do realizoje kompesimin sapo te akordohet fondi. | E plote | Nuk ka. |
| 11 | 31.01.2023 | Gazetare A. A. Kallxo.com | 01.02.2023 | Kthyer përgjigje sipas pyetjeve. | E plote | Nuk ka. |
| 452249 | 07.02.2023 | A. I Njesia Kajan, Belsh, zjarr, Djegur ullinj. | 15.02.2023 | Trajtimi i rastit të mësipërm, nuk bën pjesë në detyrat tona funksionale, por është Bashkia Belsh ajo që duhet të realizojë zgjidhjen e problematikës së adresuar. | E plote | Nuk ka. |
| 12 | 08.02.2023 | Gazetare B. H Revisa Monitor | 01.03.2023 | Kthyer përgjigje sipas kerkeses. | E plote | Nuk ka. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 13 | 09.02.2023 | L.P Bashkia Tirane, Laprake, Përmbytje 2013- 2016 | 16.02.2023 | AKMC nuk ka me detyrim financiar | E plote | Nuk ka. |
| 491242 | 13.02.2023 | Delegim ankese - A L (Ministritë e Linjës) | 16.02.2023 | AKMC do te realizoje kompesimin. | E plote | Nuk ka. |
| 486078 | 14.02.2023 | Delegim ankese - A F (Ministritë e Linjës) | 16.02.2023 | AKMC nuk ka me detyrim financiar ndaj shtetasit. | E plote | Nuk ka. |
| 487647 | 03.03.2023 | Delegim ankese – M M (Ministritë e Linjës) | 07.03.2023 | Me qëllim akordimin e ndihmës financiare, do të realizohet trajtimi dhe analizimi i dokumentacionit të disponuar. | E plote | Nuk ka. |
| 412920 | 13.02.2023 | Komunikim i brendshëm - A D (Ministritë e Linjës) | 20.02.2023 | Brenda mundësive financiare të parashikuara do të bëhet e mundur akordimi dhe komunikimi i masës së kompensimit. | E plote | Nuk ka. |
| 14 | 06.03.2023 | N. B Bashkia Elbasan | 07.03.2023 | AKMC, pas vlerësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor, nën kuadrin e akordimit të ndihmës shtetërore financiare, ka përmbushur të plotë detyrimin financiar për rastin e shtetasit. | E plote | Nuk ka. |
| 493102 | 07.03.2023 | Delegim ankese - xh m (Ministritë e Linjës) | 15.03.2023 | Me qëllim vlerësimin e rastit të shtetasit në fjalë, kemi përgatitur shkresës drejtuar Bashkisë Elbasan, nga ku kërkojmë përcjelljen e plotë të dokumentacionit tekniko-ligjor | E plote | Nuk ka. |
| 482258 | 07.03.2023 | Komunikim i brendshëm - P H (Ministritë e Linjës) | 16.03.2023 | Kërkuar informacion Bashkise per zgjidhjen e problematikës. | E plote | Nuk ka. |
| 15 | 09.03.2023 | Q.K Fshati Katundisht, Bashkia Këlcyrë, Përmet | 10.03.2023 | Kërkuar informacion nga qytetari lidhur me problematiken. | | Nuk ka. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 16 | 10.03.2023 | Q. Q. Kërkesë për targat e mjeteve te institucionit. | 13.03.2023 | Kthyer sipas kërkesës | E plote | Nuk ka. |
| 17 | 07.03.2023 | D. XH. Kërkesë për informacion | 13.03.2023 | Kthyer sipas kërkesës | E plote | Nuk ka. |
| 494767 | 15.03.2023 | Delegim ankese - K B (Ministritë e Linjës) | 16.03.2023 | Rasti në fjalë nuk është objekt trajtimi nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile. | E plote | Nuk ka. |
| 18 | 23.03.2023 | I. T. T Fshati Bucaj, Tropoje, Bajram Curr | 31.03.2023 | AKMC, nuk ka më detyrim financiar për rastin në fjalë. | E plote | Nuk ka. |
| 491996 | 24.03.2023 | Delegim ankese - P P (Ministritë e Linjës) | 27.03.2023 | AKMC, në mungesë të dokumentacionit tekniko-ligjor, nuk mund të administrojë për ndihmë financiare rastin në fjalë. | E plote | Nuk ka. |
| 480829 | 30.03.2023 | Komunikim i brendshëm - P A SHPK L P (Ministritë e Linjës) | 30.03.2023 | Subjekti në fjalë, duhet ti drejtohet njësisë së qeverisjes vendore në territorin e të cilit ndodhet. | E plote | Nuk ka. |
| 499548 | 30.03.2023 | Delegim ankese - O T (Ministritë e Linjës) | 04.03.2023 | Në buxhetin e vitit 2023 nuk është akorduar fond financiar për kompensimin e shtetasve, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme dhe për rrjedhojë nuk mund të shprehemi për afatin e gjenerimit të ndihmës financiare për shtetasin O. T. | E plote | Nuk ka. |
| [501151] | 12.04.2023 | Delegim ankese A. B. Bashkia Devoll | 12.04.2023 | Për të trajtuar rastin në fjalë, ju lutem të na informoni mbi datën e ndodhjes së fatkeqësisë dhe emrin e shtetasit në fjalë | Kërkohet informacio n. | Nuk ka. |
| 19 | 11.04.2023 | Kërkesë I. T | 19.04.2023 | AKMC ka përmbushur detyrimin ndaj qytetarit. | E plote. | Nuk ka. |
| [502468] | 24.04.2023 | Delegim ankese – n. sh. (Ministritë e Linjës) | 02.05.2023 | AKMC nuk disponon dokumentacion tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Tiranë për rastin tuaj | E plotë. | Nuk ka. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| [492631] | 03.05.2023 | Delegim ankese - M K (Ministritë e Linjës) | 04.05.2023 | AKMC bazuar analizës së elementëve të dokumentacionit tekniko-ligjor të përcjellë nga Bashkia Elbasan, ka përmbushur të plotë detyrimin financiar për rastin e shtetasin M. K | E plotë. | Nuk ka. |
| [484223] | 30.05.2023 | Komunikim i brendshëm – K. S. (Ministritë e Linjës) | 02.06.2023 | AKMC pas verifikimit të dokumentacionit tekniko-ligjor dhe përputhshmërisë me legjislacionin në fuqi, si dhe brenda mundësive të saj financiare, do të realizojë kompensimin e dëmit të shkaktuar. | E plotë. | Nuk ka. |
| 20 | 13.06.2023 | Qytetari K. S. | 19.06.2023 | AKMC pas verifikimit të dokumentacionit tekniko-ligjor dhe përputhshmërisë me legjislacionin në fuqi, si dhe brenda mundësive të saj financiare, do të realizojë kompensimin. | E plotë. | Nuk ka. |
| [493102] | 10.07.2023 | Delegim ankese - xhevit muzhaqi (Ministritë e Linjës) | 14.07.2023 | Pas kontrollit të realizuar me qëllim administrimin e rastit në fjalë, rezulton se Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile nuk përmban detyrim financiar për rastin e pretenduar, pasi nuk përfshihet në listën e shtetasve të cilët përfaqësojnë detyrimet e prapambetura financiare.<br>Për sa më sipër, bazuar akteve normative në fuqi, me efekt zbatimi në kohën e ndodhjes së fatkeqësisë, institucioni ynë nuk përmban detyrim financiar për rastin tuaj. | E plote. | Nuk ka. |
| 21 | 25.07.2023 | Kërkesë për informacion M. T. B | 27.07.2023 | Kthyer përgjigje sipas kërkesës. | E plote | Nuk ka. |
| 22 | 26.07.2023 | Kërkesë për informacion M. T. B | 27.07.2023 | Nuk është ne fushën përgjegjësisë se AKMC | Deleguar | Nuk ka. |
| 482258 | 03.08.2023 | Delegim ankese - P H Ministritë e Linjës | 08.08.2023 | Jemi në pritje të përcjelljes së dokumentacionit tekniko-ligjor. | E plote | Nuk ka. |
| 518133 | 25.08.2023 | Delegim ankese – A M Ministritë e Linjës | 08.08.2023 | AKMC në mungesë të dokumentacionit, nuk mund të ekzekutojë kompensim financiar. | E plote | Nuk ka. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 23 | 28.08.2023 | Kërkesë për informacion nga Gazetar I. A | 31.08.2023 | Kthyer përgjigje sipas pyetjeve. | E plote | Nuk ka. |
| 482258 | 13.09.2023 | Komunikim i brendshëm – P.H (Ministritë e Linjës) | 20.09.2023 | me qëllim zgjidhjen e problematikës së përsëritur për rastin e shtetasit P.H dhe orientimin e problematikës së paraqitur jemi në pritje të përcjelljes së dokumentacionit të plotë tekniko-ligjor. | E plote | Nuk ka. |
| 525300 | 15.09.2023 | Delegim ankese – S.K (Ministritë e Linjës) | 25.09.2023 | Në mungesë të dokumentacionit, nuk mund të ekzekutojë kompensim financiar. | E plote | Nuk ka. |
| 24 | 27.09.2023 | Ankese A. R bashkia Elbasan | 27.09.2023 | ka përmbushur të plotë detyrimin financiar për rastin në fjalë. | E plote | Nuk ka. |
| 25 | 29.09.2023 | Ankese L. S bashkia Lushnje | 04.10.2023 | me hyrjen në fuqi të efekteve financiare të ligjit 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, më 01.01.2020, dhe ndodhjes së fatkeqësisë natyrore më 31.08.2023, është kompetencë e Bashkisë Lushnje, administrimi i rastit të mësipërm. | E plote | Nuk ka. |
| 26 | 05.10.2023 | Interesim për situatën e zjarreve ne Pishe Poro<br>1.Si vleresohet situata me e fundit ne zone dhe a do te vijoje nderhyrja nga ajri?<br>2.Sa eshte numri i operacioneve te kryera nga avionet greke ne kete zone kuader te mekanizmit europian te mbrojtjes civile. | 06.10.2023 | Informacion mbi situatën e zjarrit në Pishë Poro<br>Në sipërfaqen pyjore të Darzezës në fshatin Pishë Poro, aktualisht situata është nën kontroll dhe nuk kemi më asnjë vatër zjarri aktive.<br>Gjatë ditës së sotme janë angazhuar efektivë të MZSH dhe të AdZM, personel nga forcat ushtarake, të cilët do bëjnë krehjen e zonës, pasi zjarri është deklaruar i shuar.<br>Aktualisht po operojnë 30 trupa të FA, 8 veta nga AdZM, 2 mjete zjarrfikëse dhe 15 efektivë të MZSH<br>Sipërfaqja e djegur, llogaritet paraprakisht rreth 650 Ha pyje.<br>Për menaxhimin e situatës nga data 27.09.2023 deri ne dt 04.10.2023 janë anagazhuar kapacitete në nivel vendor nga bashkitë Tiranë, Durrës, Dimal, Lushnjë, Divjakë, Mallakastër, Patos, Roskovec, Vlorë, Tepelenë, Himarë, | E plote | Nuk ka. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Berat, Kuçovë dhe të kompanisë “Albpetrol si dhe në nivel qëndror, përkatësisht :<br>Forcat e Armatosura: 343 Efektive<br>Mjete Forcat e Armatosura: 15<br>Forcat Zjarrfikëse: 417<br>Forcat ADZM: 63<br>Forca Bashkiake: 80<br>Mjete Zjarrfikëse: 88<br>Autoambulanca: 3 mjete<br>Policia Shtetit: 7 efektive<br>Në total janë angazhuar 910 forca operacionale dhe 106 mjete.<br>Në dt 2 dhe 3 Tetor, në mbështetje të forcave në terren, nga ajri operuan 2 avionë CANADAIR, të ofruar nga shteti grek në kuadër të aktivizimit të Mekanizmi Europian të Mbrojtjes Civile. Në total janë kryer 24 hedhje me ujë nga ajri. | | |
| 528802 | 06.10.2023 | Delegim ankese - F D (Ministritë e Linjës) | 09.10.2023 | në mungesë të dokumentacionit, nuk mund të ekzekutojë kompensim financiar. | E plote | Nuk ka. |
| 27 | 09.10.2023 | Kërkesë për mbështetje | 12.10.2023 | Trajtimi i rastit në fjalë është kompetencë e Bashkisë Tiranë. | E plote | Nuk ka. |
| 528803 | 19.10.2023 | F.D. Vlore komunën Sevaster fshati Dushkarak | 19.10.2023 | Në mungesë të dokumentacionit tekniko-ligjor nuk mund të realizohet trajtimi dhe administrimi i rastit në fjalë. | E plote | Nuk ka. |
| 494377 | 23.10.2023 | P.P LAC, përmbytjet 2019 | 30.10.2023 | Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, nën kuadrin e akordimit të ndihmës financiare për banesat e shtetasve të dëmtuar nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore, bazuar VKM-së nr. 329, datë 16.05.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose | | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", nuk disponon dokumentacion tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Kurbin për rastin e shtetasit P.p dhe, në Vendimet respektive të Këshillit Bashkiak, nr. 42, datë 22.11.2019 dhe nr. 43, datë 22.11.2019, emri i shtetasit në fjalë nuk figuron.<br><br>Për sa më sipër, në mungesë të dokumentacionit tekniko-ligjor, rasti i përcjellë nuk mund të administrohet nga ana jonë. | E plote | |
| 28 | 31.10.2023 | Jam i interesuar të di mbi mundësinë dhe kushtet ligjore që kanë strukturat civile vullnetare për të organizuar grupe vullnetare të kërkim shpëtimit ( për rastet e tërmeteve apo fatkeqësi natyrore) në Republikën e Shqipërisë. | 31.10.2023 | Bazuar kerkeses se percjelle nepermjet e-mailit tuaj, ne lidhje me kushtet ligjore per organizimin e sherbimit vullnetar dhe sherbimit vullnetar per mbrojtjen civile, percjellim informacionin si me poshte:<br><br>- Ligji nr. 45/2019 "Per mbrojtjen civile", i cili shprehet per sherbimin vullnetar te mbrojtjes civile, perkatesisht neni 38 i tij.<br>- Ne zbatim te ketij ligji, eshte miratuar VKM nr 667, date 10.11.2021 "Per trajtimin e vullnetareve per angazhimin e tyre ne aktivitete te mbrojtjes civile apo ne operacionet e parandalimit dhe te perballimit te fatkeqesive".<br><br>Gjithashtu, per organizimin e sherbimit vullnetar:<br>- Ligji nr. 45/2015 "Per vullnetarizmi".<br>- Ne zbatim te ketij ligji eshte miratuar VKM nr. 506, date 17.7.2019 "Per miratimin e kodit te etikes se vullnetarit. | E plote | Nuk ka. |
| 29 | 16.11.2023 | Kërkesë për informacion nga revista Monitor.<br>Pyetjet:<br><br>1. Ministria e Mbrojtes gjatë vitit të shkuar por edhe këtë vit nxori për | 30.11.2023 | ***<u>Pyetja nr.1</u>***<br>*Ministria e Mbrojtes gjatë vitit të shkuar por edhe këtë vit nxori për konsultim disa dokumente të rëndësishme të lidhura me emergjencat civile dhe vlerësimin e riskut nga fatkeqësitë si dhe strategjinë për zvogëlimin e riskut 2023-2030? A kemi të plotësuar me këto dokumente kuadrin* | E plote | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | konsultim disa dokumente të rëndësishme të lidhura me emergjencat civile dhe vlerësimin e riskut nga fatkeqësitë si dhe strategjinë për zvogëlimin e riskut 2023-2030? A kemi të plotësuar me këto dokumente kuadrin ligjor të nevojshëm që lidhet me një përballueshmëri më të mirë të emergjencave?<br><br>2. Cilat janë rreziqet më të mëdha me të cilat përballet vendi sipas dokumenteve dhe a ka ndërgjegjësim dhe edukim të aspektin e reagimin si nga ana e institucioneve ashtu edhe të vetë qytetarëve?<br><br>3.Ndryshimet klimatike janë evidente tashmë edhe në vendin tonë me fenomene që po përsëriten vit pas viti. Si e gjejnë veten të reflektuar këto ndryshime në | | *ligjor të nevojshëm që lidhet me një përballueshmëri më të mirë të emergjencave?*<br>**Përgjigje:**<br>Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile ka realizuar hartimin e paketës së 3 dokumentave baze të misionit të Mbrojtjes Civile: “Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë në nivel qendror”, miratuar me VKM nr.168 me datë 24.03.2023, “Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (SKZRF 2023-2030)”, miratuar me VKM nr. 94, datë 22.02.2023 dhe Plani Kombëtar për Emergjencat Civile (i cili pritet të miratohet brenda këtij muaji). Këto dokumenta plotësojnë kuadrin ligjor të nevojshëm pasi përmbajnë ekspertizë teknike (vendase dhe ndërkombëtare) të bazuar mbi: të dhëna reale zyrtare, të verifikuara të institucioneve qëndrore dhe rajonale, kërkime shkencore dhe fakte të vërtetuara mbi nivelin e riskut dhe rrezikshmërisë së fenomeneve në vendin tonë.<br>Hartimi i këtyre dokumentave ka siguruar misionin e mbrojtjes civile: për të zvogëluar risqet e fatkeqësive, për të parandaluar, përgatitur, përballuar fatkeqësitë dhe për t’u rimëkëmbur, nëpërmjet një sistemi të integruar dhe efikas.<br>***<u>Pyetja nr.2</u>***<br>*Cilat janë rreziqet më të mëdha me të cilat përballet vendi sipas dokumenteve dhe a ka ndërgjegjësim dhe edukim të aspektin e reagimin si nga ana e institucioneve ashtu edhe të vetë qytetarëve?*<br>**Përgjigje:**<br>Rreziqet kryesore ndaj të cilave vendi jonë eshte i ekspozuar, bazuar në Ligjin 45/2019 dhe dokumentin e “*Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë ne nivel qendror*” listohen si më poshtë vijon: | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | perceptimin e riskut dhe masat e marra apo përgatitjet për të minimizuar efektet?<br><br>4. Agjencia për Mbrojtjen Civile, një ent kyç në aspektin e reagimi, u riorganizua disa vite më parë. A janë përfunduar të gjithë aktet nënligjore të nevojshme dhe a është përmirësuar aspekti teknik dhe material që mundëson reagim më të mirë të saj në rast emergjencash?<br><br>5. Çfarë investimesh janë bërë sa i takon një reagimi më të mirë në rastet e emergjencave?<br><br>6. Një rol të rëndësishëm në aspektin e reagimit në rast emergjencash merr edhe pushteti vendor. A ka sot një koordinim më të mirë mes hallkave institucionale në këtë aspekt dhe a po | | 1. Përmbytjet,Vërshimet e ujit dhe Çarjet e digave Tërmetet;<br>2. Zjarret në pyje;<br>3. Aksidentet teknologjike<br>4. Termetet<br>5. Sëmundjet infektive;<br>6. Rrëshqitje e tokës, reshjet e dëborës dhe ortekët<br>Për të arritur qëllimin e ndërgjegjësimit dhe edukimit të misionit të mbrojtjes civile, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile ka ndërmarrë një sërë programesh me fokus mbështetjen teknike për fuqizimin e kapaciteteve lokale të mbrojtjes civile në të gjithë vendin, aktivitete ndërgjegjësuese me komunitetin në disa bashki, me sistemin arsimor 9 vjecar, me disa universitete përmes leksioneve të hapura etj. Gjithashtu, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile ka bëre tradite *13 Tetorin*- Dita Ndërkombetare e Zvogelimit të Riskut, ku cdo vit zhvillohen aktivitete sensibilizuese dhe informuese në të gjithe vendin, konkurse në shkolla etj. Sa i përket ndërgjegjësimit të qytetarëve, po planifikohen fushata në kuadër të misionit të mbrojtjes civile, si dhe implementimi i Programit të Trajnimit të Mbrojtjes Civile me struktura të ndryshme të sistemit operacional të mbrojtjes civile si Forcat e Armatosura, Sherbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimi, Policia e Shtetit, Urgjenca mjekësore, grupe vullnetare.<br><br>***<u>Pyetja nr.3</u>***<br>*Ndryshimet klimatike janë evidente tashmë edhe në vendin tonë me fenomene që po përsëriten vit pas viti. Si e gjejnë veten të reflektuar këto ndryshime në perceptimin e riskut dhe masat e marra apo përgatitjet për të minimizuar efektet? (Referohu SKZRF 2023-2030)*<br>**Përgjigje:** | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | punohet konkretisht në ndonjë drejtim për të përmirësuar këtë?<br><br>7. AKMC ka si detyrim edhe inspektimin në insitucionet shtetërore sa i takon përmbushjes së detyrimeve që lidhen me mbrojtjen civile. Çfarë konstatohet nga këto inspektime? | | Marrëveshja e Parisit dhe Axhenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm (përfshirë Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm) theksojnë rëndësinë e përshtatjes klimatike dhe zvogëlimit të riskut të fatkeqësive. UNDRR thekson se nëse duam të zvogëlojmë riskun, ne gjithashtu duhet të bashkohemi në qasjet tona dhe duhet të përfshijmë të gjithë sektorët përkatës, të bashkëpunojmë brenda institucioneve dhe të sigurojmë harmoni nga politika në aktivitet. Nevoja për koherencë midis Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike (PNK) dhe ZRF është identifikuar nga OZHQ-të në nivel global dhe nga BE-ja në nivel rajonal. Gjetjet dhe raportet ekzistuese të PNK-së që vijnë nga burime të ndryshme që flasin për kushtet e qëndrueshme të temperaturave të larta dhe reshjeve të ulëta, ndryshimin e modeleve dhe shpeshtësinë e situatave që shkaktojnë përmbytje të shpejta dhe rrëshqitje të tokës, ndër të tjera, nuk kontestohen nga sektori i ZRF.<br>Duke e njohur këtë, Shqipëria vendosi të zhvillojë praktikat duke lidhur të gjitha strategjitë përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare në një qëllim të përbashkët – të zvogëlojë humbjet nga fatkeqësitë dhe të sigurojë zhvillim të qëndrueshëm. Marrja në konsideratë e ndryshimeve klimatike ka impaktuar drejtëpërdrejt dokumentin e Vlerësimit të Riskut nëpërmjet: simulimit të skenarëve më afatgjatë per majtjen e riskut apo rivlerësimit të koeficentëve në sistemin e pikëzimit që rankojnë riskun.Ky impakt është dhënë nga faktorët kryesorë: Temperatura,Rreshjet dhe Rritja e nivelit të detit (SLR). Për shembull: Ndryshimet e parashikuara në modelet e rreshjeve gjatë muajve të dimrit,vjeshtës dhe pranverës rrisin riskun e përmbytjeve të lumenjve.<br>Masat e marra janë reflektuar në dokumentin e Strategjisë Kombëtare ZRF duke kushtëzuar fushat e ndërhyrjes dhe | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | zbatimit nepërmjet: Menaxhimit të riskut ekzistues dhe parandalimit për risqet e reja dhe Forcimit të kapacitetve të përgjigjes. Konkretisht në 60 projektet e Planit të Veprimit per ZRF për Shqipërinë 2023 -2030.<br><br>***<u>Pyetja nr.4</u>***<br>*Agjencia për Mbrojtjen Civile, një ent kyç në aspektin e reagimi, u riorganizua disa vite më parë. A janë përfunduar të gjithë aktet nënligjore të nevojshme dhe a është përmirësuar aspekti teknik dhe material që mundëson reagim më të mirë të saj në rast emergjencash?*<br>**Përgjigje:**<br>Krijimi i AKMC si institucion, ka vënë në përgjegjësi të plotë të gjitha njësitë e saj përbërëse duke siguruar bashkëpunimin funksional. Bashkërendimi i proçeseve të punës në bazë të hierarkisë institucionale,ka sjellë përmbushjen e detyrave dhe qëllimeve. Sa i përket akteve nënligjore janë miratuar deri tani 19 të tilla, te cilat kane vene ne funksion përmbushjen e detyrimeve nderinstitucionale dhe garantojne fuqizimin e sistemit. Ndërkohë, janë në proces hartimi dhe rishikimi disa akte nënligjore si numri i unifikuar 112 i emergjencave civile, për krijimin e rrjetit vullnetar, mbi kriteret e sistemeve TESTA dhe CECIS të Mekanizmit Europian të Mbrojtjes Civile, mbi infrastrukturen kritike nga institucionet përgjegjese.<br>***<u>Pyetja nr.5</u>***<br>*Çfarë investimesh janë bërë sa i takon një reagimi më të mirë në rastet e emergjencave?*<br>**Përgjigje:**<br>Në kuadër të politikës kombëtare të parandalimit dhe zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë, duke menaxhuar në nivel rajonal dhe vendor fatkeqësitë natyrore, përmes | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | investimeve publike dhe private në marrjen e masave strukturore dhe jostrukturore, përgjatë vitit 2022-2023, janë investuar dhe shpallur fituese projektet si më poshtë vijon:<br>**Për vitin 2022**<br>Referuar nenit 15 të ligjit 115/ 2021, "Për buxhetin e vitit 2022", është alokuar fondi në zërin shpenzime kapitale në programin, *"Emergjencat civile"* të Ministrisë së Mbrojtjes i cili është përdorur sipas kritereve në aneksin 6, "Fondi për Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore", dhe është shpërndarë në projektet e shpallura fituese si më poshtë vijon:<br>1. "Mbrojtje nga gërryerjet e lumit Osum në zonën e Dafinave, Bashkia Dimal", Bashkia Dimal.<br>2. "Rehabilitimi i rezervuarve e përrenjve që ndodhen në territorin e Bashkisë Divjakë", Bashkia Divjakë.<br>3. "Rikonstruksioni i argjinaturës për mbrojtjen nga lumi Vjosa, zona Kafaraj-Çerven (Bankina e Degës së Martinës Prog. 4668 ml-prog. 6000 ml L=1332 ml)", Bashkia Fier.<br>4. "Mbrojtje lumore në lumin Pavëll pranë Urës së Bogazit", Bashkia Konispol.<br>5. "Ndërhyrje për shmangien e përmytjeve dhe erozionit në Bashkinë Korçë", Bashkia Korçë.<br>6. "Ndërhyrje me pilota në rrugën Ballagat-Hysgjokaj", Bashkia Lushnjë.<br>7. "Mur me pilota në rrugën "Vëllezërit Frashëri" L=50 ml; Rehabilitimi i kanalit të ujërave të larta dhe ndërtim i murit mbajtës përgjatë pallateve", Bashkia Lushnjë.<br>8. "Ndërtim ura Pojate e Poshtme, Tamare", Bashkia Malësi e Madhe.<br>9. "Ndërtim stacion pompimi Vreshtas+Linja", Bashkia Maliq. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 10. “Ndërtim i pritave lumore dhe përforcim i këmbëve të urës në shtratin e lumit Shkumbin”, Bashkia Peqin.<br>11. “Rehabilitimi i kanalit (përroit) në fshatin Pustec”, Bashkia Pustec.<br>12. “Ndërhyrje emergjente në fshatin Ngjeqar, Njësia Administrative Kurjan”, Bashkia Roskovec.<br>13. “Mur mbajtës përgjatë lumit Osum te ish Kantieri i N.SH.N”, Bashkia Skrapar.<br><br>**Për vitin 2023**<br>Bazuar në Ligjin 45/2019, “Për Mbrojtjen Civile”, nenit 15 të ligjit 84 / 2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, aneksit 6 “Fondi për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore”, është realizuar shpërndarja e fondit të akorduar sipas përcaktimeve të aneksit për 30 projektet e shpallura fituese si më poshtë vijon:<br>1. “Zhbllokim i shkarkuesve dhe kanal ujëmbledhës”, Bashkia Maliq<br>2. “Rikonstruksion i kanalit kryesor përroi i Lingajces nga rruga e fushës deri te lagja e Hallidrit, fshati Rrajcë, Nj. A Rrajcë”, Bashkia Prrenjas.<br>3. “Sistemimi i shtratit të përoit në Gorice e Madhe për mbrojtjen e fshatit nga përmbytja”, Bashkia Pustec.<br>4. “Punime per rehabilitimin e shkarkuesit, rezervuari Vrijon dhe Sistemim i përroit lagja nr. 3, Kovaçe, Krujë”, Bashkia Krujë.<br>5. “Rehabilitim dhe veshje me beton, Kanali Drenovë, Ndërtim tombino BOX 2X (5x3 m), fshati Gurmujas dhe Rikonstruksion i rruges auto pyjore Denas”, Bashkia Korçë<br>6. “Reduktimi i pasojave të përmbytjes e zonën e nën Shkodres”, Bashkia Shkodër. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 7. “Mbrojtje nga përroi Jezull në fshtin Jezull, Rrëshen”, Bashkia Mirditë.<br>8. “Rehablitim, përforcim, tre Ura Rruga Ngjec-Pec, Nj. A Golaj dhe Rehabilitim kunetes dhe bazamentit i kanalit të betonit, përroi Tërshenes”, Bashkia Has.<br>9. “Rikonstruksion ure pasarel në fshatin Rreth-Bazë, NJ. A Bazë”, Bashkia Mat.<br>10. “Rindërtimi i mureve mbajtës të shesheve të pallateve në Qytetin Fushë-Arrëz”, Bashkia Fushë-Arrëz.<br>11. “Rehabilitimi i diges se ures se Pcemit”, Bashkia Përmet.<br>12. “Mbrojtje nga ujerat e larta dhe sistemimi i perroit te SMT”, Bashkia Devoll.<br>13. “Rezervuar i Gjonçit, Prita malore në fshatrat Mësiçkë, Taç Poshtë”, Bashkia Kolonjë.<br>14. “Ndertim i ures tip bailey, perroi i Çumes (Dushit), ne rrugen automobilistike Kurad-Grabova NJA Lenie”, Bashkia Gramsh.<br>15. “Mbrojtje lumore gjatesore nga lumi Osum, fshati Mbrakull, Poliçan”, Bashkia Poliçan.<br>16. “Rehabilitim i urave në fshatrat gështenjë, Orgjost”, Bashkia Kukës.<br>17. “Sistemim i lumit te Buçimasit dhe rehabilitim i infrastruktures rrugore përgjat tij Loti-I”, Bashkia Pogradec.<br>18. “Ndërtim ura të reja, rikonstruksion ura e vepra ujitëse”, Bashkia Tropojë.<br>19. “Përforcim terreni nga rrëshqitja në zonën e NJ. A Nr. 2, Nr. 4, Ishëm”, Bashkia Durrës.<br>20. “Ura lidhese per fshatrat Vermosh-Velan-Velipoje”, Bashkia Malësi e Madhe.<br>21. “Ndërtimi i rrjetit të hidrantëve për Krastën”, Bashkia Elbasan. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 22. “Ura auto ne fshatin Plan”, Bashkia Pukë.<br>23. “Trajtim rreshqitje rruge ne fshatin Peshkepi”, Bashkia Selenicë.<br>24. “Rehabilitim emergjent i perroit te Gjerozes tek Fresku L=620 m”, Bashkia Tiranë.<br>25. “Mbrojtje nga gerryerja e rruges kryesore ne perroin e Lumasit, Krahu i majte prane Ures se Lumasit, ndërtimi i tre urave ne perroin e Saraselasit, Belesoves dhe Mendrakes, si dhe ndertimi i rruges lidhese”, Bashkia Kuçovë.<br>26. “Mbrojtja nga përroi i Selosë, Dropull, Faza I”, Bashkia Dropull.<br>27. “Mbrojtje lumore në fshtin Arrëz, Bashkia Dimal”, Bashkia Dimal.<br>28. “Ndërhyrje për sigurinë e rezervuarit të Ngjeqarit”, Bashkia Roskovec.<br>29. “Masa inxhinierike për stabilizimin e rrëshqitjes së masës në kodren e Cfakës, pranë rrugës nacionale Gjirokastër-Kakavijë, loti 2”, Bashkia Gjirokastër.<br>30. “Ndërtim Urë Beton-Arme 4*17 m mbi Lumin Mat, në fshatin Dom, Nj. A Gurrë, Klos”, Bashkia Klos.<br><br>***<u>Pyetja nr.6</u>***<br>*Një rol të rëndësishëm në aspektin e reagimit në rast emergjencash merr edhe pushteti vendor. A ka sot një koordinim më të mirë mes hallkave institucionale në këtë aspekt dhe a po punohet konkretisht në ndonjë drejtim për të përmirësuar këtë?*<br>**Përgjigje:**<br>Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) ka ngritur mekanizmat e ofrimit të bashkëpunimit dhe suportit teknik maksimal për strukturat e pushtetit vendor konkretisht | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | nepërmjet organizimit të takimeve, tryezave teknike të punës, proçeseve të inspektimit dhe raportimit në kuadër të Mbrojtjes Civile. Këto dhe aktivitete të ngjashme e kanë sjellë stafin e AKMC më afër njohjes së problematikave në nivel vendor dhe ofrimit të mbeshtetjes për zgjidhjen e tyre. Shkëmbimi i informacionit dhe gatishmëria nga njësitë përbërëse të AKMC në raport me strukturat e qeverisjes vendore ka lehtësuar  përmbushjen e proçeseve të punës dhe po sjell koordimin më efiçent edhe ne drejtim te krijimit te bazes se te dhenave te humbjeve nga fatkeqesite. Paralelisht me proceset e planifikimit strategjik, ne po rrisim gjithashtu kapacitetet tona të përgjigjes duke modernizuar dhe forcuar kapacitetet për shërbimin tonë të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit. Një sere projektesh me fokus forcimin operacional do te fillojne implementimin ne vitin 2024.<br>***Pyetja nr.7***<br>*AKMC ka si detyrim edhe inspektimin në insitucionet shtetërore sa i takon përmbushjes së detyrimeve që lidhen me mbrojtjen civile. Çfarë konstatohet nga këto inspektime?*<br>**Përgjigje:**<br>Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile ka realizuar me sukses programin e inspektimit për periudhën shkurt-korrik 2023.<br>Ky program ka pasur një qëllim të rëndësishëm: Të sigurojë që strukturat në fushën e mbrojtjes civile,si strukturat qëndrore, vendore dhe private, të zbatojne detyrimet ligjore (Ligji nr.45/2019 për Mbrojtjen Civile) me përgjegjësi për përmbushjen e detyrimeve dhe përgjegjësive për të garantuar mbrotjen nga fatkeqësitë. Përfaqësuesit kanë kryer inspektim të hollësishëm dhe të përpiktë te subjektet për të verifikuar përputhjen me standartet dhe proçedurat e duhura.Në raste kur është zbuluar mosfunksionimi i | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | përgjegjësive administrative, janë ndërmarrë hapa konkretë për të përmirësuar situatën. Në përmbledhje të informacionit sa më sipër, rezultati i këtij programi është:<br>Nga 46 inspektime dhe kontrolle (Shkurt – Korrik 2023) kryer në:<br>• 3 Struktura Qëndrore<br>• 17 Struktura Vendore<br>• 6 Subjekte Private<br>Mangesite kryesore te konstatuara jane mungesa e planeve operacionale ne rastin e nje emergjence, mungese e stafit te dedikuar dhe te specializuar ne menaxhimin e riskut te fatkeqesive, mosrespektimi i detyrimit ligjor mbi planifikimin buxhetor te fondeve te mbrojtjes civile etj. | | |